

LIGJ
Nr.9261, date 22.7.2004

**PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE LIGJIN NR.7796, DATE
17.2.1994 "MINERAR I SHQIPERISE"**

Ne mbeshtetje te neneve 78 dhe 83 pika I te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave"

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Ne ligjin nr.7796, date 17.2.1994 "Minierar I Shqiperise", behen keto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Titulli I ligjit ndryshohet ne "LIGJI MINERAR I SHQIPERISE "

Neni 2

Ne **nenin 3** behen ndryshime si me poshte :

1. "**Mineral**" nenkupton çdo substance te dobishme, ne gjendje te ngurte, te lenget ose te gazte, qe ndodhet ne trajte natyrore, mbi toke ose nen toke, ne uje ose nen uje, ne sterilet e minierave te shfrytezuara apo ne dambat e fabrikave te pasurimit, skorjet e metalurgjise se zeze dhe me ngjyre, te formuar prej proceseve gjeologjike, duke perjashtuar naften, ne gjendje te lenget, gazin natyror, ne gjendje te gazte dhe ujin, por duke perfshire reren, guret, shkembinjte, zhavorrin dhe argjilat.
Rerat, zhavoret, zhuret trajtohen, sipas ketij ligji, ne rastet kur nuk perfshihen ne percaktimet e bera ne ligjin nr.8093, date 21.3.1996 "Per rezervat ujore ".
2. Pas emerimit "Mineral" shtohet nje paragraf me kete permbajtje:
"**Veprimtari minerare**" nenkupton te gjithë punet, qe lidhen me kerkimin, zbulimin, zhvillimin, shfryte4zimin, perpunimin tregetimin e produkteve minerare, si dhe kujdesin, mirembajtjen, monitorimin ose mbylljen e minierave, duke pasur parasysh edhe rehabilitimin e mjedisit".

Neni 3

Ne fund te nenit 10 shtohet nje Paragraf me kete permbajtje:

“Ne zonat e shpallura nga Keshilli I Ministrave si “gjeomonumente dhe terrene ne vlera te veçanta natyrore”, e drejta minerare jepet me vendim te Keshillit te Ministrave”.

Neni 4

Paragrafi I dyte I nenit 16 ndryshohet si me poshte :

“Insituti I Teknologjise se Nxjerrjes dhe Perpunimit te Mineraleve eshte institucion I specializuar shkencor qe siguron, per ministrine e linjes dhe Drejtorine e Pergjitheshme te Minerave, asistence teknike, nepermjet projekteve, monitorimeve dhe veprimtarive te tjera per politikat dhe veprimtarite minerare, qe kane lidhje me kete ligj”.

Neni 5

Titulli I kapitullit VI “**NDERMARRJET MINERARE SHTETERORE**” ndryshohet ne “**SHOQERITE QE USHTROJNE VEPRIMTARI MINERARE**”.

Neni 6

Neni 18 ndryshohet si me poshte :

“Neni 18

Veprimtarite minerare qe lidhen me projektimin, administrimin, kerkim-zbulimin dhe shfrytezimin e mineraleve ne territorin e Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjlistacionin shqiptar, ushtrohen nga shoqerite tregetare, persona juridike, me perjashtim te rasteve qe parashikohen ne nenet 66 dhe 69 te ketij ligji”.

Neni 7

Neni 19 ndryshohet si me poshte:

“Neni 19

Shoqerite koncensionare, te perfshira ne veprimtarite minerare, u neneshtrohen dispozitave te ketij ligji “.

Neni 8

Neni 20 ndryshohet si me poshte “

“Neni 20

Veprimtaria minerare, ne teresi, qe lidhet me projektimin, vleresimin, konsulencen, monitorimin dhe drejtimin teknik te shoqerive kryhet nga specialiste, te pajisur me leje nga ministri perkates, sipas kriterëve te miratuara nga Keshilli I Ministrave”.

Neni 9

Ne nenin 40, shprehja “ekuivalenti ne leke I 300 frangave zviceriane behet “30 000 leke”.

Neni 10

Ne fund te paragrafit te dyte te nenit 47, pas fjales “specifikohen” hiqen fjalet “prej tij” dhe shtohen “ne rregulloren e miratuar prej tij”.

Neni 11

Ne nenin 48, pas fjaleve “nje e tere” shtohet shprehja “ e percaktuar ne hapesire, sipas 3 koordinatave”.

Neni 12

Ne nenin 50, shprehja “ekuivalentin ne leke te 3 000 dhe, ne vlere maksimale, ekuivalentin ne leke te 10 000 frangave zviceriane per nje km²”, behet “300 000 leke dhe, ne vleren maksimale 1 000 000 leke per nje km²”.

Neni 13

Ne fund te shkronjes “c” te nenit 52. pas fjaleve “per shfrytezim” shtohen fjalet “pasi te kene marre lejet perkatese per veprimtari te tilla, ne perputhje me legjislacionin shqiptar”.

Neni 14

Ne nenin 63 shprehja “ekuivalenti ne leke I 100 frangave zviceriane” zevendesohet me” 10 000 leke”.

Neni 15

Ne shkronjen “b” te nenit 69 shprehja “ e cila duhet te paraqitet se paku tridhjete dite perpara mbarimit te periudhes se mepareshme” hiqet.

Neni 16

Ne nenin 73 shprehja “ ne leke sa ekuivalenti prej 1500 frangave zvicerane” zevendesohet me “150.000 leke”.

Neni 17

Pas nenit 74, shtohet neni 74/1 me kete permbajtje:

“Neni 74/1

Paragrafet dy dhe tre te nenit 47, nenet 53, 54, 55, 56, 57, 58, 60, 61 dhe 62 zbatohen edhe per mineralet e grupit te katert, ndersa neni 59 zbatohet per nje afat se paku prej 30 ditesh”.

Neni 18

Ne nenin 102, shprehja “ prej ekuivalentit ne leke te 100 frangave zvicerane “ zevendesohet me “30 000 leke”.

Neni 19

Ne nenin 105, shprehja “jo me pak se ekuivalenti ne leke I 50 000 frangave zvicerane dhe jo me shume se ekuivalenti ne leke I 500 000 frangave zvicerane per çdo shkelje “zevendesohet me “jo me pak se 500 000 leke dhe jo me shume se 5 000 000 leke per çdo shkelje”.

Neni 20

Neni 106 ndryshohet si me poshte :

“Neni 106

1. Shkeljet e meposhteme perbejne kundravajtje administrative dhe Drejtoria e Pergjitheshme e Minierave ka te drejte te vendose gjobat, si me poshte :

- a) kur, pas dhenjes se lejes, verehet se ne kerkesen per leje minerare ka te dhena dokumentare-financjare te pasakta, gjoba eshte 100 000 leke;
- b) kur kryhen shkelje te detyrimeve, qe jane percaktuar ne lejen minerare, gjoba eshte 50 000 leke;
- c) kur ne menyre te pajustificueshme, ulet prodhimi ne nje zone minerare te lejuar, gjoba eshte nga 10 000 leke deri ne 50 000 leke;
- ç) kur kryhen shkelje te tjera te ligjit minerar, gjoba eshte nga 50 000 leke deri ne 100 000 leke.

2. Ne rast perseritje te shkeljeve te percaktuara ne shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” dhe kur shoqeria mbyll ose ndalon punen ne nje miniere per njeqind e tetedhete dite rresht, subjektit I hiqet leja minerare.

Kundravajtesit kane te drejte te ankohen te ministri perkates brenda 1 muaji nga data e venjes se gjobes”.

Neni 21

Pas nenit 106 shtohet neni 106/1 me kete permbajtje :

“Neni 106/1

Kunder vendimit te ministrit subjekti ka te drejten e ankimit, sipas ligjit “Per kundravajtjet administrative”.

Neni 22

Ne tabelen “Grupi I katert” “Mineralet dhe materialet e ndertimit”, shtohen edhe fjalet “ranoret, konglomeratet, traktolitet dhe bazaltet”.

Neni 23

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare

Shpallur me dekretin nr.4290, date 2.8.2004 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Alfred Moisiu